



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 41, DATË 31 / 03 / 2021

**PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E DËMTUARA
NGA PËRMBYTJET TË SHKAKTUARA NGA RRESHJET E DENDURA NË
NJËSITË ADMINISTRATIVE SUKTH, KATUND I RI, SI DHE NJËSIA
ADMINISTRATIVE NR.6, BASHKIA DURRËS**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB-së Nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe Projekt-Buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë Durrës nr.60, datë 01.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e rënies të rreshjeve të datave 25-26 janar 2021 në territorin e Bashkisë Durrës”, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë Durrës nr.122, datë 22.02.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e rënies të rreshjeve të datave 10-11 shkurt 2021 në territorin e Bashkisë Durrës” dhe sipas Relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile dhe nga komisionet e vlerësimit, ngritur me Urdhërin nr. 60, datë 01.02.2021 dhe Urdhërin nr.122, datë 22.02.2021, Zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI


1. Miratimin e ndihmës financiare prej 47,013,200 (dyzeteshtatë milion e trembëdhjetë mijë e dyqind) lekë për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga rreshjet e dendura në Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri si dhe Njësia Administrative Nr.6 Bashkia Durrës në zbatim të procedurave të VKM-së nr 329/2012 sipas listës

2. Ky fond do të mbulohet nga fondi i emergjencës i Bashkisë Durrës, viti 2021, i ndarë si më poshtë:
- Vlera prej 26.000.000 lekë, nga transfertat e pakushtëzuara sektoriale për mbrojtjen civile për vitin 2021.
 - Diferenca prej 21.013.200 lekë, nga të ardhurat e veta të Bashkisë Durrës.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar si dhe Drejtoria e Buxhetit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK


Dorina Milja

Me porosi dhe me mundësi

Almeida Fosh



U shpall sot më datë 01.04.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 247/prot.
19



Durrës, më 07.04.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 41 datë 31.03.2021 “Për akordimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmytjet e shkaktuara nga rreshjet e dendura në Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri si dhe Njësia Administrative Nr. 6, Bashkia Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

